



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Informacion periodik i Kolegjit të Posaçëm të Apelit mbi çështjet e regjistruara dhe vendimet

Kolegji i Posaçëm i Apelit vijon të ushtrojë funksionin e tij në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, pas paraqitjes së ankimit nga subjektet e rivlerësimit apo Komisioneri Publik ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Deri në datën 31 dhjetor 2022, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka shpallur 175 vendime të Juridiksionit të Rivlerësimit, nga të cilat 12 janë shpallur në vitin 2018, 34 janë shpallur gjatë vitit 2019, 42 gjatë vitit 2020, 38 vendime gjatë vitit 2021 dhe 49 vendime gjatë vitit 2022.

Deri më 31 dhjetor 2022, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë regjistruar 304 çështje të juridiksionit të rivlerësimit, 40 gjatë vitit 2018, 62 gjatë vitit 2019, 63 çështje gjatë vitit 2020, 86 çështje gjatë vitit 2021 dhe 53 çështje gjatë vitit 2022.

Sa i përket Juridiksionit Disiplinor, deri më 31 dhjetor 2022, në Kolegjin e Posaçëm të Apelit janë regjistruar 16 çështje të këtij Juridiksioni, nga të cilat 2 në vitin 2018, 1 në vitin 2019, 11 çështje gjatë vitit 2021 dhe 2 çështje gjatë vitit 2022.

Deri më 31 dhjetor 2022, janë marrë gjithsej 14 vendime të Juridiksionit Disiplinor, 6 vendime përfundimtare dhe 8 vendime për moskalim të çështjes në seancë plenare. Gjatë vitit 2018 janë shpallur 2 vendime: 1 vendim përfundimtar dhe 1 për moskalim të çështjes në seancë plenare; gjatë vitit 2020 është shpallur 1 vendim përfundimtar; gjatë vitit 2021 është shpallur 1 vendim përfundimtar dhe 3 vendime për moskalim të çështjes në seancë plenare; gjatë vitit 2022 janë marrë 3 vendime përfundimtare dhe 4 vendime për moskalim të çështjes në seancë plenare.

[Për informacion më të plotë, klikoni këtu](#)